



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 20/11

Prishtinë, më 18.07.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami Xhevdet Neziraj, dhe Albana Fetoshi.

Mungoi: Naser Osmani, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza-MF, Xhevat Azemi-AKP, Aleksander Beetz, Ramadan Islami nga GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më datë 13.07.2011**
3. **Shqyrtimi i Marrëveshjes për Llogarinë të Trustit në mes të Agjencisë për zhvillim ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për Arsim Themelor,**
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
4. **Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencisë Kosovare të Pronës,**
Scott Bowen, Drejtor Ekzekutiv i AKP-së dhe Bedri Hamza, Ministër i Financave;
5. **Miratimi i propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit, I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**
6. **Miratimi i propozim – amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore, I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**
7. **Shqyrtimi i Propozim–vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave, I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**

8. Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik – shtator 2011; I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;
9. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për ripërcaktimin e pagës mujore të kryetares së KKTK-së;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-013 për Kadastër, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
11. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Rendi i ditës u miratua me plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 13.07.2011

Kryetarja, shprehu vërejtjet te rekomandimi për Avokatin e Popullit që të qartësohet më mirë.

Procesverbali miratohet me vërejtjet e kryetares.

3. Shqyrtimi i Marrëveshjes për Llogarinë e Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për Arsim Themelor

Kryetarja, sqaroi se kjo marrëveshje parasheh obligimin e Republikës së Kosovës që në Llogarinë e Trustit të depozitojë 5.000.000 €, nga 1.000.000 € për çdo vit gjatë periudhës 2011-2015. Pasi që marrëveshja parasheh transferin e mjeteve nga viti 2011 nga përfituesi, e cila vlerë do t'i nënshtrohet procedurave të Buxhetit të Republikës së Kosovës kërkoj nga Ministri i Financave sqarime lidhur me këto mjete se a janë përfshirë në buxhetin e vitit 2011 dhe se a do të përfshihen edhe në buxhetin e viteve vijuese?

Bedri Hamza, sqaroi se kjo marrëveshje që është nënshkruar në mes të USAID-it dhe institucioneve të Republikës së Kosovës ka të bëjë me përmirësimin e kapaciteteve institucionale në sektorin e arsimit dhe përmirësimin e kualitetit sidomos në arsimin fillor. Kjo marrëveshje ka implikime buxhetore, për shkak se një pjesë e fondeve janë të siguruar nga USAID-i si donacion, mirëpo kërkohet një bashkëfinancim nga institucionet e Kosovës për zbatimin e plotë të kësaj marrëveshjeje. 1.000.000 € janë ndarë nga institucionet e Kosovës, të cilat janë përfshirë në tabelat e buxhetit të vitit 2011, konkretisht janë pjesë në Ministrinë e Arsimit. Gjithashtu këto mjete janë të planifikuara edhe për vitet e ardhshme.

Hykmete Bajrami, pyeti sa do të jetë kontributi i USAID-it në këtë marrëveshje dhe kush do t'i implementoj projektet?

Bedri Hamza, u përgjigj se implementimi do të bëhet përmes institucioneve të Kosovës me mbështetjen e USAID-it.

Kryetarja, sqaroi se në marrëveshje është i bashkangjitur edhe totali, i cili përfshinë kontributin e USAID-it dhe atë të institucioneve të Kosovës.

Komisioni njëzëri, nxorri këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikoj Marrëveshjen për Llogarinë të Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës, lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për Arsime Themelor.

4. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Agjencisë Kosovare të Pronës

Kryetarja, theksoi se kërkesa ka të bëjë me një shtesë, mirëpo nuk është e detalizuar ashtu siç është kërkuar nga komisioni.

Xhevat Azemi, sqaroi se AKP-ja deri në vitin 2008 është financuar 80% nga donacionet dhe 20% nga buxheti i Kosovës, mirëpo me kalimin e viteve është rritur financimi nga buxheti i Kosovës. Stafi i AKP-së që përbëhet prej 170 punëtorëve, përveç rrogës bazë që e marrin nga buxheti i Kosovës, e marrin edhe një shumë të caktuar nga donacionet, për shkak të rrezikshmërisë në punës. Kërkesa buxhetore për vitin e kaluar ka pasur të bëjë me një shtesë prej 80% për të punësuarit, përveç rrogës bazë që ata e marrin nga buxheti i Kosovës. Meqenëse ka qenë e kufizuar shuma e mjeteve të lejuara, kjo kërkesë prej 365.000 € sa ka qenë në fillim është zvogëluar në 165.887 € për shtesat në paga dhe mëditje. Mirëpo, kjo shtesë nuk po mund të realizohet, sepse kjo nuk mund të shprehet përmes koeficientit. AKP-ja nuk kërkon mjete shtesë, por kërkon që këto mjete që janë në buxhet të mundësohet shfrytëzimi i tyre.

Bedri Hamza, kërkoi sqarime lidhur me atë se mbi çfarë baze ligjore AKP-ja i llogaritë pagat, sipas Ligjit për Shërbyesit Civil është e nevojshme të specifikohet kërkesa e tyre, për shkak se Ministria e Financave nuk është kompetente për llogaritjen dhe përgatitjen e listës së pagave. Adresa e shqetësimit të AKP-së duhet të jetë Ministria e Administratës Publike për t'i kuptuar se si janë mundësitë për realizimin e kërkesës së tyre.

Hykmete Bajrami, pyeti se a kemi filluar jo zyrtarisht të bëjmë rishikim të buxhetit përderisa pranojmë kërkesa të tilla, sepse ka mjaft institucione që dëshirojnë të bëjnë lëvizje të tilla?

Bedri Hamza, sqaroi se buxheti i Kosovës është aprovuar në mars dhe ka filluar të ekzekutohet në prill dhe për ta bërë rishikimin në qershor nuk ka pasur ndonjë arsyeshmëri që për dy muaj organizatat buxhetore të mos jenë në gjendje t'i bëjnë planifikimet e tyre dhe brenda dy muajve të kërkojnë të bëjnë ndryshime. Ligji i buxhetit jep mundësi që deri në 5% të totalit të ndarjeve buxhetore të mund të rialokohen pa problem. Kjo jep fleksibilitet të mjaftueshëm për organizatat buxhetore që të bëjnë rirregullimet e nevojshme. Edhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, rishikimi i buxhetit është neutral, që do të thotë se nuk ka mundësi që në rishikim të ketë rritje të buxhetit, por vetëm mund të bëhen rregullime të brendshme brenda kufijve të buxhetit.

Xhevat Azemi, njoftoi se i kanë pasur disa takime me Ministrinë e Administratës Publike, mirëpo qëndrimi i tyre ka qenë që të ketë një lejim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa për këto mjete shtesë, pasi që kjo nuk mund të shprehet përmes koeficienteve dhe se AKP-ja është agjencion e pavarur që i përgjigjet Kuvendit. Qëndrim i tillë ka qenë edhe nga zëvendësudrejtori i buxhetit në Ministrinë e Financave.

Sali Asllanaj, kërkoi nga Ministri që të bëhen përpjekje për ndryshimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike për të bërë një zgjidhje unike për të gjitha këto organizata buxhetore, sidomos në lëmin e pagave ku ekziston një disharmoni e plotë, sepse komisioni po ballafaqohet vazhdimisht me kërkesa të tilla të padefinuara.

Hasime Krasniqi, shprehu mendimin se Ligji për Shërbyesit Civilë duhet të respektohet pa dallim për të gjithë shërbyesit civilë. Kur është planifikuar buxheti i këtij agjencioni, është planifikuar më tepër se sa paga bazë që e lejon Ligji për Shërbyesit Civilë. Pa një arsyeshmëri të fortë nuk mund të pranohet kjo kërkesë.

Xhevdet Neziraj, pyeti se a kanë të gjithë këta 170 punëtorë rrezikshmëri në punë dhe sa a janë të gjithë ekspertë?

Bedri Hamza, sqaroi se buxhetin e agjencioneve të pavarura Ministria e Financave vetëm e propozon, ndërsa Kuvendi është ai që e cakton. Duhet pasur parasysh edhe natyrën specifike të disa organizatave, të cilat janë financuar 100% nga donacionet dhe gradualisht kanë kaluar në financimin nga buxheti i Kosovës. Kërkesa e AKP-së nuk mund të zgjidhet brenda Ministrisë së Financave, sepse nuk kemi kurfarrë autorizimi ligjor për të njohur kërkesën e tyre për shtesat në pagat e tyre. Sqaroi se duhet pasur parasysh se pagat e disa agjencione të pavarura nuk i nënshtrohen Ligjit për Shërbyesit Civilë, disa bazohen në ligje tjera e disa në vendime që i merr Kuvendi dhe janë pjesë e Ligjit të Buxhetit.

Kryetarja, theksoi nëse AKP-ja dëshiron që t'i rregullohet çështja sikur se AKK-së, atëherë duhet të analizohet lista e të punësuarve për të parë me të vërtetë se a ka dikush që është me rrezikshmëri në punë. Komisioni nuk ka bazë ligjore për të marrë ndonjë vendim për të zëvendësuar pagat të cilat i marrin si shtesë nga donatorët. Sqaroi se stafi i agjencioneve të pavarura është staf civil, sepse edhe në shkresën që ka ardhur nga AKP-ja tregohet se është në përpunje të plotë me koeficientet që kanë shërbyesit civilë.

Komisioni me gjashtë voto Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj) dhe një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe asnjë Kundër, nxorri këtë:

PËRFUNDIM

- I. Komisioni vlerësoi se nuk ka bazë ligjore për të rekomanduar për kërkesën buxhetore të AKP-së, për zëvendësimin e shtesave të stafit civil vendor të AKP-së nga buxheti i donatorëve, në buxhetin e këtij agjencioni, brenda buxhetit të Republikës së Kosovës.

5. Miratimi i propozim - amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit

Kryetarja, në mungesës së kryesuesit të grupit punues Naser Osmani dhe anëtarit të grupit punues Latif Gashit, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

PËRFUNDIM

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit, shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit.

6. Miratimi i propozim - amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore

Kryetarja, njoftoi se Projektligji për Ndhmën Shtetërore është në kuadër të projektligjeve që kërkohet të miratohen nga raporti i progresit.

Hykmete Bajrami, theksoi që ky projektligj ka kosto buxhetore, mirëpo ajo nuk është cekur në asnjë amendament. Gjithashtu shprehu vërejtje për formulimin e nenit 4, me të cilin kuptohet se ligji është për ndërmarrjet të cilat nuk parashikohen në këtë ligj, ndërsa propozoi që në amendamentin 2 të fshihet fjala “ndryshe”.

Komisioni njëzëri miratoi **amendamentin 2**, me ndryshimin e propozuar nga Hykmete Bajrami.

Sali Asllanaj, lidhur me amendamentin 3 theksoi që është plotësisht i panevojshëm, sepse kjo lëmi nuk zgjidhë problematikën e partneritetit publiko-privat.

Kryetarja, theksoi që grupi punues e ka vlerësuar të nevojshëm këtë amendament për shkak që të evitohen të gjitha keqkuptimet kur përdoret ndihma financiare, buxhetore apo ndonjë ndihmë tjetër. Ky propozim amendament ka ardhur nga Zyra e USADI-it dhe grupi punues me modifikimet e nevojshme, që të jetë më shkurtër, njëzëri e ka përkrahur.

Komisioni njëzëri miratoi **amendamentin 3**, pa ndryshime.

Hykmete Bajrami, pyeti lidhur me amendamentin 5 se çka na duhet zyra nëse për këtë ligj nuk kemi buxhet?

Kryetarja, sqaroi se ky ligj do të hyjë në fuqi në vitin e ardhshëm dhe të gjitha institucionet janë të obliguara të parashikojnë me buxhetet e tyre mjete për ndihmën shtetërore. Ngarkesë për buxhetin janë këta pesë punëtorë të cilët duhet të përfshihen në buxhetin e vitit të ardhshëm dhe të viteve vijuese.

Bedri Hamza, sqaroi se aktualisht janë duke u dhënë ndihma të karakterit social, prej rezervës emergjente që janë të shpërndara nëpër organizata buxhetore. Qëllimi është që të vendoset rregull dhe të kanalizohen ndihmat aktuale, mirëpo edhe nëse ka ndonjë fond të ri që të bëhet pjesë e buxheteve.

Komisioni njëzëri miratoi **amendamentin 5**, pa ndryshime.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Miratohen propozim - amendamenteve të grupit punues për Projektligjin nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore, me ndryshimin e bërë në Komision dhe raporti me amendamente procedohet për miratim në procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave

Bedri Hamza, kërkoi nga komisioni që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër të radhës, pasi që nevojiten edhe disa informata shtesë, sepse CV-të e kandidatëve të propozuar nuk janë

të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, si dhe nuk janë të tri gjuhët. Po ashtu Qeveria nuk e ka propozuar kryesuesin siq kërkohet me ligj.

Kryetarja, u pajtua me Ministrin për këtë mungesë të dokumentacionit përcjellës që duhet t'u bashkangjitet këtyre CV-ve. Në kohën kur Qeveria do ta procedojë prapë duhet të jap një arsyeshmëri se shtatë prej anëtarëve të bordit vijnë prej komunitetit të biznesit, pasi që ligji parasheh një kusht të këtillë si dhe të propozohet kryesuesi.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

P Ë R F U N D I M

1. I rekomandohet Qeverisë që t'i dërgojë Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Buxhet dhe Financa, dokumente shtesë që argumentojnë përgatitjet universitare, përvojën dhe trajnimet të cekura në përmbajtjet e CV-vë të anëtarëve të propozuar për emërim në Bordin për Rishqyrtimin e Ankesave, si dhe biografitë e anëtarëve të propozuar të dërgohen në gjuhën shqipe dhe serbe.
2. Qeveria në pajtim me nenin 78.3 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të propozojë njërin prej anëtarëve Kryesues të Bordit për Rishqyrtimin e Ankesave.

8. Shqyrtimi i projeksioneve të buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik-shtator 2011

Kryetarja, sqaroi se në buxhetin e vitit 2011 është miratuar edhe buxheti i RTK-së duke e marrë një vendim që RTK-ja të paraqesë projeksionet e të hyrave buxhetore për periudhën tremujore në mënyrë që të ketë mundësi për ekzekutimin e pagesave të mëtutjeshme. Projeksionet për periudhën korrik-shtator janë sjellur, megjithëse se me vonesë në Kuvend, si dhe është dërguar raporti gjashtë mujor i shpenzimeve. Komisioni duhet të jap një rekomandim për administratë e Kuvendit, për ekzekutimin e buxhetit të kërkuar.

Rrahman Paçarizi, sqaroi se shkak i vonesës së projeksioneve është se nuk ka pasur mundësi të dorëzohet raporti para se të mbyllet gjashtë mujori. Shpenzimet në tremujorin e parë kanë qenë më të larta dhe tani RTK-ja punon me borxhe. Projeksionet e buxhetit për periudhën korrik-shtator 2011, janë të harmonizuara me shpenzime të reduktuara në mënyrë që të mund të përshtatemi me buxhetin, i cili është ndarë.

Hasime Krasniqi, përgëzoi për faktin se qysh në fillim janë marrë masat e para për rimëkëmbjen e një qëndrueshmërie financiare të RTK-së. Shihet që gjatë këtij gjashtë mujori kemi rritjen e të hyrave të RTK-së dhe zvogëlimin e shpenzimeve si rezultat i menaxhimit të mirë. Në përgjithësi vërehet se është bërë një vlerësim i arsyeshëm, i cili nuk do të sjellë pengesa gjatë punës së tyre.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr. 1110101219060187, në shumën prej 1,761.333 Euro, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2011.

9. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për ripërcaktimin e pagës mujore të kryetares së KKTK-së

Kryetarja, Njoftoi e kërkesa për rritjen e pagës së kryetares, e cila nuk do të jetë më e vogël se pesë rroga mujore mesatare të një nëpunësi të sektorit publik, bazohet në aktet e brendshme që ka nxjerrur ky Këshill. Sipas ligjit përkatës, Këshillit i mundësohet që me akte të brendshme të përcaktojë organizimin dhe funksionimin e tij dhe jo edhe propozimin e pagave për anëtarët e Këshillit. Meqenë se këtij Këshilli i ka skaduar mandati më 2 tetor 2010, komisioni nuk mund të trajtojë një kërkesë të këtillë dhe të rekomandojë për atë.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

PËRFUNDIM

I. Anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore i'u ka skaduar mandati më 2 dhjetor 2010 dhe si rezultat komisioni nuk mund të trajtojë dhe rekomandojë kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për ripërcaktimin e pagës mujore të kryetares së KKTK-së.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për Kadastër, me raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

11. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

Kryetarja, theksoi që ky ligj kërkohet edhe me raportin e progresit dhe rekomandime që janë dhënë në raportin e progresit janë të përfshira në projektligj.

Hykmete Bajrami, theksoi që puna e prokurimit publik në Kosovë është shumë komplekse dhe problematike dhe për këtë sugjeroi që të formohet një grup i madh punues për të kontribuar sa më shumë që është e mundur. Gjithashtu propozoi që në grup punues të merr pjesë edhe ndonjë anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Albana Fetoshi, sugjeroi që në rastin kur vijnë projektligje të tilla të mos caktohen shumë pika të rendit të ditës ose të mbahet një mbledhje e veçantë vetëm për këto projektligje.

Sali Asllanaj, propozoi që të organizohet edhe një dëgjim publik me organet kompetente që merren me këtë fushë dhe për të parë defekte në këtë fushë që do të ndihmonin në amendamentimin e këtij projektligji.

Kryetarja, sqaroi se është e pamundur të caktohet rendi i ditës vetëm me një ose dy pika, për shkak të ngarkesës së punëve që janë në komision, mirëpo për këtë projektligj duhet të punohet në detale dhe të analizohet çdo nen me kujdes.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

I. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Prokurimin Publik.

12. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-019 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verërat, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

13. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për t'u diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj